

**INFORMACION NË LIDHJE ME KOMENTET/REKOMANDIMET/OPINIONET
E PALËVE TË INTERESUARA/GRUPEVE INTERESI, SI DHE PROCESIN E
SHQYRTIMIT TË TYRE, PËR PROJEKTAKTET E KONSULTUARA, GJATË
VITIT 2021**

I. Projektligji “Për rezervat materiale të shtetit”

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (i pranuar/i pranuar pjesërisht/i refuzuar)	Justifikimi
Detyrimi i operatorëve ekonomikë për të hyrë në marrëdhënie kontraktore me DPRMSH.	-Prodhimi i mallrave apo ofrimi i shërbimeve të bëhet përkundrejt pagesës. - kjo e drejtë të mos i njihet institucionit në çdo rast por vetëm në situata të tilla që diktojnë nevojën për të ndërhyrë në lirinë e veprimtarisë ekonomike të subjekteve.	▪ Shaga sh.p.k; ▪ Erdis sh.p.k;	Pranuar	Propozimet e operatorëve u vlerësuan si të drejta dhe u pranuan nga ana e grupit të punës.

II. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të	Vendimi (i pranuar/i pranuar pjesërisht/i refuzuar)	Justifikimi
--	---	--	---	-------------

		ngjashme)		
Kohëzgjatja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak në rezervë.	Të ndryshojë dhe të bëhet: Nga 4 deri në 7 ditë të ndryshojë dhe të bëhet nga 10 deri në 15 ditë.	J-3/7 (Shtabi i Përgjithshëm i FA) Akademia e Forcave të Armatosura	Refuzuar	Nuk është gjykuar e nevojshme përfshirja e këtij ndryshimi pasi ligji aktual e parashikon mundësinë e zgjatjes së afatit deri në 14 ditë.
Mbi moshën maksimale për kryerjen e shërbimit ushtarak në rezervë	Të ndryshojë dhe të bëhet: Shërbimi ushtarak në rezervë kryhet nga shtetasit e moshës: a) deri 45 vjeç për ushtarët; b) deri 55 vjeç për nënoficerët; c) deri 60 vjeç për oficerët.”	Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (Ministria e Mbrojtjes); Qendra e Personel Rekrutimit; Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë.	Pranuar	Propozimi konsiderohet i drejtë pasi ndryshimi bën të mundur përputhjen me ndryshimet e reja në ligjin nr.59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
Mbi moshën maksimale për kryerjen e shërbimit ushtarak në rezervë	Të ndryshojë dhe të bëhet: Shërbimi ushtarak në rezervë kryhet nga shtetasit e moshës: a) deri 55 vjeç për ushtarë/detarë aktiv dhe nënoficer (meshkuj); b) deri 50 vjeç për ushtarë/detarë aktiv dhe nënoficer (femra); c) deri 65 vjeç për oficer meshkuj; ç) deri 60 vjeç për oficer femra.	Komanda e Forcës Ajrore	Refuzuar	Projektligji, ndër të tjera synon shmangien e përdorimit të dallimeve me bazë gjinore si dhe unifikimin e terminologjisë me ligjin nr.59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
E drejta e ruajtjes së vendit të punës	Të ndryshojë dhe të bëhet: Shtetasi, i cili i ndërpret marrëdhëniet (kontratën) e punës për shkak të detyrimit për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ, ka të drejtën e	Komanda Mbështetëse	Pranuar	Sugjerimi u vlerësua i drejtë dhe u reflektua në përmbajtjen e projektligjit.

	rikthimit në vendin e punës. Subjektet shtetërore dhe private janë të detyruara ta ripunësojnë atë.			
Kufizimet për moskryerjen e shërbimit ushtarak aktiv ose alternativ	Të hiqet dispozita që përcakton “Shtetasit shqiptar, që nuk e ka kryer fizikisht shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose kursin profesional përkatës, i ndalohej punësimi si ushtar me pagesë ose nënoficer në Forcat e Armatosura, në rolin bazë të Policisë së Shtetit, në Gardën e Republikës dhe në policitë e tjera të krijuara me ligj”.	Komanda Mbështetëse	Refuzuar	Sugjerimi nuk është pranuar pasi ky nen është shfuqizuar nga ligji nr.9999, datë 25.9.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
Kundërvajtjet administrative (neni 40)	Të ndryshojë masa e gjobës nga “3000 deri në 30 000 lekë” në 10 000 deri në 50 000 lekë.	Akademia e Forcave të Armatosura	Refuzuar	Nga struktura propozuese nuk është argumentuar nevojën e ndryshimit të masës dhe ku janë mbështetur konkretisht për dhënien e këtij propozimi. Nga ana nuk vlerësohet e nevojshme ndryshimi i masës administrative.
Shlyerja e detyrimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ me pagesë (Neni 42)	Të hiqet dispozita që përcakton se : “Shtetasit shqiptar, që plotëson kriteret e vendosura nga ky ligj për kryerjen e detyrimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ, mund t’i njihet i shlyer ky detyrim kur, me dëshirën dhe kërkesën e vet, paguan personalisht dhe menjëherë një shumë të caktuar lekësh. Kriteret dhe shuma e detyrimit në	Komanda Mbështetëse	Refuzuar	Sugjerimi nuk është pranuar pasi vetë legjislatori ka vendosur një afat për zbatimin e kësaj dispozite. Me kalimin e këtij afati detyrimi bie në dekadencë.

	këto raste përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky nen do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2010".			
--	--	--	--	--

III. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.13/2015 "Për policinë ushtarake në Forcat e Armatosura të RSH".

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (i pranuar/i pranuar pjesërisht/i refuzuar)	Justifikimi
	Në nenin 4, pas fjalës "specializuar" të shtohen fjalët "për veprime policore".	Njësia e personelit	Pranuar	Sugjerimi u konsiderua i drejtë dhe u reflektua në përmbajtjen e projektaktit.
	Në nenin 41, pika 3, fjalët "në masën e gjysmës së pagës mujore" të ndryshohet dhe bëhet "në masën e pagës mujore" (propozim i përbashkët me seksionin e financës së PU).	Njësia e personelit	Pranuar	Sugjerimi u konsiderua i drejtë dhe u reflektua në përmbajtjen e projektaktit.
	Në nenin 3 pas fjalës "shërbim" të shtohet dhe fjala "stërvitje".	Njësia e operacioneve	Pranuar	Sugjerimi u konsiderua i drejtë dhe u reflektua në përmbajtjen e projektaktit.
	Në germën "k", të nenit 33, shtohet fjalia "lista e personave dhe funksioneve që gëzojnë të drejtën e shoqërimit dhe sigurimit nga Policia Ushtarake, përcaktohet me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të	Njësia e operacioneve	Refuzuar	Ky sugjerim u pranua nga grupi i punës por në fazën e bashkërendimit me ministrinë e linjës u kundërshtua nga MFE.

	Armatosura’.			
	Në nenin 7, pas togfjalëshit "me veprimet e tyre..." të shtohet togfjalëshi "ose mosveprimet e tyre...".	Njësia e PK dhe PGJ	Pranuar	Sugjerimi u konsiderua i drejtë dhe u reflektua në përmbajtjen e projektaktit.
	Në nenin 10, pika 4 emërtimi "grada" të zëvendësohet me emërtimin "funksionet".	Njësia e PK dhe PGJ	Refuzuar	Është shfuqizuar si pikë në projektligjin e ri me argumentin se me miratimin e ligjit nr. 25/2019 “Për policinë gjyqësore” i ndryshuar kjo dispozitë ka rënë, dhe nuk ka arsye të bëheb përcaktime shtesë në projektligjin tonë.
	Në pikën 3, të nenit 18, fjalët “..me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm ...” zëvendësohen me fjalët “...me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes...” .	Njësia e PK dhe PGJ	Refuzuar	Ky sugjerim u pranua nga grupi i punës por në fazën e bashkërendimit me Prokurorinë e Përgjithshme dhe MD, u kundërshtua me argumentin se bie ndesh me parimet kushtetuese dhe liritë dhe të drejtat e njeriut.
	Në pikën 3, të nenit 20, fjalët “miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të mbrojtjes dhe prokurorit të përgjithshëm” zëvendësohet me togfjalëshin “... me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes”	Njësia e PK dhe PGJ	Refuzuar	I njëjti argument si më sipër.
	Pas germës “c” të nenit 21 të shtohet germa “d” me këtë përmbajtje d “për të dhënë deklarime rreth rrethanave të ngjarje”.	Njësia e PK dhe PGJ	Pranuar	Sugjerimi u konsiderua i drejtë dhe u reflektua në përmbajtjen e projektaktit.
	Në germën “b” të pikës 1, të nenit 29, pas fjalëve “ të ndaluar” të shtohet	Njësia e PK dhe PGJ	Pranuar pjesërisht	Ky sugjerim është pranuar pjesërisht në përputhje me sugjerimit e MB dhe MD.

	togfjalëshi “ plotëson në sistemin përkatës të policisë së shtetit..”.			
	Në germën “P”, të nenit 33, togfjalëshi "mbrojnë pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë nga veprimtari të kundërligjshme ” zëvendësohet me togfjalëshin “ mbështet mbrojtjen e pronës dhe pasurisë shtetërore në administrim dhe përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë nga veprimtari të kundërligjshme.	Njësia e PK dhe PGJ	Pranuar	Sugjerimi u konsiderua i drejtë dhe u reflektua në përmbajtjen e projektaktit.
	Pas pikës 3 të nenit 36 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: 4. Policia ushtarake nuk mund të japë informacion për çështje në hetim gjatë fazës së hetimeve paraprake për procedimet penale të regjistruara në prokuroritë përkatëse sipas kodit të procedurës penale.	Njësia e PK dhe PGJ	Pranuar pjesërisht	Ky propozim nuk mund të pranohej plotësisht pasi bie në kundërshtim me legjislacionin fuqi.
	Pika 1 e nenit 39, ndryshon dhe bëhet: “Gjatë përmbushjes së detyrave të caktuara me ligj, punonjësi i policisë ushtarake zbaton rregulloren e brendshme të policisë ushtarake të miratuar	Njësia e rendit ushtarak	Pranuar	Sugjerimi u konsiderua i drejtë dhe u reflektua në përmbajtjen e projektaktit.

	me urdhër të Ministrit të mbrojtjes”			
	Germa “n”, e nenit 33, ndryshon dhe bëhet: “kontrollon masat parandaluese, jep asistencë teknike dhe ndërhyr për forcimin e masave dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri”.	Njësia e MNZSH	Pranuar	Sugjerimi u konsiderua i drejtë dhe u reflektua në përmbajtjen e projektaktit.